REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 28 datë 24.04.2026

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "NDËRTIMI I OBJEKTIT TË MAGAZINIMIT TË PËRKOHSHËM TË ARMATIMIT", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Ndërtimi i objektit të magazinimit të përkohshëm të armatimit", me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I


E D I R A M A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

ERVIN DEMO



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA KOKA



Nënshkruar më datë 30 /10/ 2026